

Nr. Protokolli: 544/2026
Data: 07.07.2026

Bazuar në Ligjin Nr. 02/L-42 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2013, Rregulloren e Brendshme për Regjistrimin e Nxënësve të Kolegjit ISPE, Vendimeve për Riakreditim të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Vendimin Nr. 01/149, të datës 19.03.2024 dhe Vendimin Nr. 01/363, të datës 02.05.2025, si dhe bazuar në Vendimet e Komisionit për Licencim të MASHTI-t, Vendimin Ref. Nr. 3/878, të datës 20.05.2024, dhe Vendimin Ref. Nr. 3/1000, të datës 30.05.2025, Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale, në kuadër të Kolegjit ISPE, shpall:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLËN E MESME TË LARTË PROFESIONALE NË KUADËR TË KOLEGJIT ISPE PËR VITIN SHKOLLOR 2026/2027

- Konkursi shpallet për Drejtimet/Kualifikimet e Validuara dhe Akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve si dhe të Licencuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që janë:
 - Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë;
 - Teknik Dentar;
 - Asistent i Fizioterapisë;
 - Teknik i Farmacisë dhe
 - Teknologji e Informacionit Komunikimit dhe Elektronikë.
- Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve:
 - Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë përfunduar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë mbi moshën 17 vjeç;
 - Nxënësit, të cilët e kanë përfunduar klasën e IX jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe më pas të konkurrojnë për regjistrim.
- Dokumentet e nevojshme për konkurrim:
 - Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të, duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - Fletëparaqitjen (e cila merret në Kolegjin ISPE);
 - Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9);

Prishtinë, 07/07/2026

-Çertifikatën e lindjes dhe

-Dy fotografi.

4. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve:

-Paraqitja e dokumenteve për vitin shkollor 2026/2027, bëhet nga data 08.07.2026 deri më datë 14.08.2026;

-Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen më datën 17.08.2026.


-Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet nga data 18.08.2026.

-Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), përkatësisht në Komisionin për Ankesa.

Prishtinë,

8 Korrik 2026

Drejtori i Kolegjit ISPE



Prof. Dr. Avni Mazreku

